

R R E G U L L O R E

Nr.1, Datë 28.09.2021

**PËR PROCEDURAT E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONEVE DHE VEPRIMET ADMINISTRATIVE
PËR NJOHJEN SI PERIUDHË SIGURIMI PËR EFEKT PËRFITIMI NGA SIGURIMET SHOQËRORE
TË KOHËS SË PUNËSIMIT NË ISH-KOOPERATIVAT BUJQËSORE”, NE ZBATIM TE LIGJIT NR.
169/2020**

Mbështetur në shkronjën “e”, të nenit 74, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore miraton këtë Rregullore:

KREU I

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

Objekt i Rregullores “Për procedurat e funksionimit të komisioneve dhe veprimet administrative për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore, të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, në zbatim të Ligjit nr. 169/2020.” (në vijim Rregullorja), janë vetëm kërkesat për njohje të periudhës së punësimit në zbatim të Ligjit nr. 169/2020, në ish-kooperativat bujqësore sipas listës së miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 15.7.2021 “Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”.

Qëllimi i Rregullores është të përcaktojë rregullat e funksionimit të komisioneve, procedurat e aplikimit, rregullat e administrimit të praktikave, procedurat e shqyrtimit dhe përpunimit të kërkesave/deklaratave, lidhur me njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore në

zbatim të Ligjit nr. 169/2020 dhe VKM nr. 432/2021 dhe evidentimin e tyre në vërtetimin përfundimtar të vjetërsisë në punë për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore.

Neni 2

Baza Ligjore

Rregullorja mbështetet në legjislacionin si vijon:

Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”;

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 15,7,2021 “Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”;

Në dispozitat e Ligjit nr. 4976, date 29.6.1972 “Për pensionet për anëtarët e kooperativave bujqësore”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, lidhur me dokumentimin e punës për efekt pensioni, në ish-kooperativat bujqësore.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Rregullorja është e detyrueshme për zbatim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe strukturat rajonale e lokale në varësi të tij. Dokumentet e lëshuara bazuar në këtë Rregullore përdoren vetëm për efekt të përfitimeve nga sistemi i sigurimeve shoqërore.

Neni 4

Periudhat e Sigurimit

Bazuar në nenin 2, të Ligjit nr. 169/2020, për të gjithë personat që kanë punuar në ish-kooperativat bujqësore, të cilët nuk kanë dokumentacion të vërtetimit të periudhës së sigurimit dhe të ditëve të punës të kryera për çdo muaj apo vit kalendarik, për arsye se dokumentacioni mungon dhe njësi ekonomike ku kanë punuar është evidentuar në listat bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432/2021.

Njihet si periudhë sigurimi për efekt pensioni, koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, bazuar në kërkesë deklaratën e verifikuar të personit kërkues, nga data e fillimit të punës në ish-kooperativë bujqësore, deri më datë 17.09.1991 kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për token", por jo më përpara se mosha për punë në kooperativat bujqësore përcaktuar nga legjislacioni i kohës.

Periudha e sigurimit njihet në varësi të datës së fillimit, vijimësisë dhe të datës së mbarimit të punës në ish-kooperativë bujqësore dhe evidentohet në *"vërtetimin e periudhës së sigurimit"*, sipas formatit bashkëlidhur, për çdo vit kalendarik, në ditë-punë ose ditë-norma (Kooperativa Bujqësore e Tipit të Lartë) të plota. Bazuar në nenin 91, të Ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 92, datë 4.5.1978, i ndryshuar, me Vendimin nr. 323, datë 14.11.1978 *"Për dokumentimin dhe kriteret e llogaritjes së vjetërsisë në punë për anëtarët e kooperativave bujqësore"*.

Periudhat e punës pranë ish-kooperativave bujqësore do të njihet:

- a) për burrat: një vit i plotë sigurimi njihet i barabartë me 280 ditë pune ose ditë-norma, për analogji një muaj i plotë sigurimi njihet me 23 ditë pune.
- b) për gratë: një vit i plotë sigurimi njihet i barabartë me 230 ditë pune ose ditë-norma, për analogji një muaj i plotë sigurimi njihet me 19 ditë pune.
- c) Për personat që kanë përfituar pension invaliditeti, periudha e punës në ish-kooperativë bujqësore, përpara fillimit të pensionit të invaliditetit, njihet sipas ditëve të punës mbi bazën e të cilave është caktuar pensioni i invaliditetit, ndërsa periudha e përfitimit të pensionit të invaliditetit të plotë njihet si periudhë e plotë sigurimi bazuar në nenin 19 të Ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 *"Për pensionet për anëtarët e kooperativave bujqësore"*, për përfitimet që periudha e trajtimit me pension invaliditeti njihet si periudhë sigurimi nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore.

Në bazë të nenit 19, të Ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 *"Për pensionet për anëtarët e kooperativave bujqësore"*, të ndryshuar, si vjetërsi pune me ditë pune mujore të plota, përfshihet edhe koha e qëndrimit pa punë e ish-anëtarit të kooperativës bujqësore, që

ndërpret punën për të ndjekur bashkëshortin e transferuar jashtë shtetit ose në pikat kufitare, në territorin e të cilave nuk mund të sistemohet në punë.

Në bazë të pikës 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 92, datë 4.5.1978, të ndryshuar, me Vendimin nr. 323, datë 14.11.1978 “Për dokumentimin dhe kriteret e llogaritjes së vjetërsisë në punë për anëtarët e kooperativave bujqësore”, viti i parë i krijimit të kooperativës bujqësore njihet si vit i plotë vjetërsie në punë, kur personi ka punuar në kooperativë bujqësore në vazhdim, por jo përpara moshës 14 vjeç.

Njihet si periudha e sigurimit për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore, vetëm kur vërtetohet se gjatë periudhës së deklaruar kërkuesi:

- a) Nuk ka qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie;
- b) Nuk ka qenë përfitues i pensionit të invaliditetit të plotë;
- c) Nuk ka qenë duke kryer shërbimin ushtarak;
- d) Nuk ka periudha të tjera vjetërsie në punë të mbivendosura me periudhat e punës të deklaruara në ish-kooperativat bujqësore;
- e) Ka qenë banor i territorit në të cilin ka shtrirë aktivitetin e saj ish-kooperativa bujqësore;
- f) Ka qenë duke frekuentuar arsimin tetëvjeçar apo të mesëm pa shpërndarje nga puna.

KREU II

KËRKESA, PROCEDURA E APLIKIMIT, PËRPUNIMIT, ADMINISTRIMIT DHE VENDIMMARRJA

Neni 5

Procedurat e aplikimit dhe dokumentacioni

Procedura e njohjes së periudhës së punësimit, në ish-kooperativat bujqësore, në zbatim të Ligjit nr. 169/2020 dhe sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432/2021, fillon vetëm në bazë të kërkesës së Përfituesit.

Kërkesa për njohjen e periudhës së punësimit në zbatim të Ligjit nr. 169/2020, në ish-kooperativat bujqësore të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 432/2021, bëhet në çdo kohë dhe së bashku me dokumentet e përcaktuara paraqitet dhe administrohet në sportelet e shërbimit, në ato bashki ku ndodhet vendbanimi i përhershëm i personit, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin që rregullon mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel.

Neni 6

Administrimi i kërkesave dhe praktikave në DRSSH

Specialisti i protokollit në Drejtorinë Rajonale regjistron në një regjistër tip kërkesat e ardhura, i vendos praktikës numrin dhe datën e protokollit, pajis praktikën me kartelën shoqëruese operationale (*formati tip bashkëlidhur*), bën shënimet përkatëse në të, si dhe brenda ditës së nesërme të punës i kalon tek titullari ose tek punonjësi i autorizuar prej tij.

Titullari i Drejtorisë Rajonale, ose punonjësi i autorizuar, bën shënimet përkatëse në rubrikën e fletës operationale dhe brenda ditës së nesërme të punës i adreson praktikën te Kryetari i Degës së Arkivit.

Kryetari i Degës së Arkivit brenda tre ditëve të punës bën veprimet e përcaktuara për çdo kërkesë të administruar, regjistron praktikën në një regjistër tip, bën shënimet përkatëse në kartelën shoqëruese operationale, kryen procedurat përkatëse për nxjerrjen e dokumentacionit të detyrueshëm të parashikuar në Shtojcën 1.

Praktika e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm, shqyrtohet në mbledhjen e radhës të Komisionit të përpunimit të praktikave “Për njohjen e periudhave të punësimit në ish-kooperativat bujqësore në zbatim të Ligjit nr. 169/2020”.

Neni 7

Ngritja, përbërja dhe funksionimi i Komisionit të përpunimit të praktikave “Për njohjen e periudhave të punësimit në ish-kooperativat bujqësore në zbatim të Ligjit nr. 169/2020”

Në Drejtorinë/Degët Rajonale ngrihet Komisioni i përpunimit të praktikave "Për njohjen e periudhave të punësimit në ish-kooperativat bujqësore në zbatim të Ligjit nr. 169/2020", (në vijim Komisioni) dhe funksionon si një strukturë me vendimmarrje kolegjiale.

Komisioni përbëhet nga 3 anëtar dhe kryetari. Kryetari i Komisionit është Kryetari i Degës së Arkivit ndërsa anëtarë janë një specialist i Degës së Arkivit, një specialist i Degës së Kontributeve, si dhe jurist në detyrë.

Komisioni ngrihet me urdhër të veçantë të Drejtorit Rajonal sipas përcaktimeve në këtë Rregullore dhe në një pikë të veçantë të urdhërit, shënohet përbërja e Komisionit me emër, mbiemër dhe detyra funksionale.

Anëtarët e Komisionit qëndrojnë në këtë komision deri në 5 vjet, ndërsa kryetari i Komisionit është Kryetari i Degës së Arkivës në detyrë. Për arsye të përligjura dhe anëtarë të veçantë, afati i caktuar mund të përsëritet apo mund të zgjatet. Për arsye të përligjura ai edhe mund të ndërpritet. Ndërprerja bëhet me vendim të Drejtorit Rajonal, i cili bën edhe zëvendësimin.

Neni 8

Afatet dhe procedurat e shqyrtimit të dokumentacionit në Komision

Komisioni mblidhet në varësi të fluksit të kërkesave, kur ka kërkesa jo më pak se një herë në javë.

Data dhe ora e mbledhjes caktohet me urdhër nga kryetari i Komisionit.

Mbledhja konsiderohet e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se dy anëtar dhe kryetari. Në këtë rast që vendimi të ketë fuqi zbatuese duhet të jenë dakord (të nënshkruhet) nga të gjithë pjesëmarrësit.

Kryetari dhe anëtarët, në mungesë të tyre nuk mund të përfaqësohen në mbledhje të veçanta nga punonjës të tjerë, vetëm nëse vendoset me një urdhër të veçantë të

arsyetuar të Drejtorit Rajonal. Në këtë rast kryetari zëvendësohet nga specialisti më i vjetër në detyrë në degën e Arkivit, specialistët e Degës së Arkivit dhe të Degës së Kontributeve zëvendësohen me specialistë nga dega e tyre dhe juristi, nga një jurist tjetër në detyrë. Në rast se në strukturën organizative të DRSSH-së apo DSSH-së ka vetëm një jurist në detyrë, ai zëvendësohet nga një punonjës që ka titullin universitar “Jurist”, por më kusht që ky i fundit të mos jetë pjesëmarrës në hallkat e mëtejshme administrative të trajtimit të kërkesës për përfitim të rastit të shqyrtuar.

Komisioni shqyrton dokumentet e paraqitura/administruara nga dega e Arkivit të DRSSH dhe fillimisht vlerëson nëse kërkesa është në kompetencë të tij për shqyrtim, sipas parashikimeve në këtë Rregullore. Mos kompetenca për shqyrtim, shprehet në Vendimin e Komisionit, ku evidentohen edhe arsyet. Në këtë rast dokumentet i kthehen zyrtarisht të interesuarit.

Të gjithë anëtarët e Komisionit, shprehin në mënyrë individuale dhe të mirëargumentuar mendimin e tyre për çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e argumenteve përbën shkak vlerësimi të profesionalizmit për specialistin përkatës dhe për prishjen e vendimit nga strukturat audituese të ISSH.

Nëse një anëtar nuk është dakord me Vendimin e shumicës, harton relacion “mendim pakice”, me argumentet kundër. Relacioni pasi nënshkruhet nga anëtari i bashkëngjitet vendimit të Komisionit dhe bashkëlidhet me dokumentet që qëndrojnë në DRSSH.

Mbledhjet e Komisionit faktohen në procesverbal, në të cilin pasqyrohen në mënyrë të plotë dhe të detajuar: data e zhvillimit të mbledhjes, pjesëmarrësit, rrethanat e çështjes, dokumentacioni i paraqitur dhe i administruar, mendimi i secilit anëtar, përfundimi dhe vendimmarrja.

Urdhëri i kryetarit për mbledhjen e Komisionit, procesverbali i mbledhjes, praktikat individuale të kërkuesve, dokumentacioni i administruar (dokumentacioni i dërguar nga kërkuesi si dhe plotësimet e bëra nga Dega e Arkivit) dhe vendimi i Komisionit për kërkuesin, administrohen në Degën e Arkivit, ku arkivohen si praktika të veçanta dhe

mbahen deri në momentin e kërkesës për caktim përfitimi nga personi i interesuar. Nga ky moment praktika zyrtarisht do të bëhet pjesë e dosjes së pensionit.

Nëse krahas kërkesës “Për njohje të periudhës së punësimit në ish-kooperativë bujqësore për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore në zbatim të Ligjit nr. 169/2020”, apo gjatë kohës së shqyrtimit në komision, përfituesi ka bërë edhe kërkesën për caktim përfitimi, e gjithë praktika e kërkuesit e administruar nga komisioni, dërgohet në Degën e Përfitimeve nëpërmjet protokollit të DRSSH, jo më vonë se 3 (tre) ditë kalendarike nga data e vendimit të Komisionit. Transferimi i informacionit koordinohet midis Degës së Përfitimeve dhe Degës së Arkivit.

Neni 9

Vendimmarrja e Komisionit

Komisioni çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo dokumenti veçmas dhe të gjitha dokumenteve së bashku. Komisioni merr vendim brenda ditës së mbledhjes kur dokumentacioni është i plotë dhe kur vlerëson se duhen kryer verifikime shtesë, komisioni merr vendim në mbledhjen e radhës nga plotësimi i dokumentacionit.

Në përfundim të shqyrtimit dhe të vlerësimit të dokumentacionit, komisioni vendos:

a) Moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, kur për periudhën objekt shqyrtimi:

- i.** ka një vendim gjyqësor të formës së prerë që ka rrëzuar kërkesën për vërtetimin e periudhës së punësimit objekt shqyrtimi;
- ii.** kur subjekti nuk është në listën e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 432/2021;
- iii.** kur kërkuesit i është caktuar përfitim nga sigurimet shoqërore, përpara datës 23.01.2021, data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 169/2020;
- iv.** kur periudha e punësimit nuk kërkohet për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore.

b) Mosshqyrtimin e kërkesës:

- i. kur komisioni është shprehur një herë për periudhën objekt vlerësimi dhe nuk ka prova të reja të pashqyrtuara më parë;
- ii. kur kërkuesi heq dorë nga kërkesa;

ç) Njohjen e plotë/të pjesshme të periudhave të punës, kur sipas rastit periudhat objekt shqyrtimi, provohen pjesërisht apo plotësisht.

Vendimi i Komisionit duhet të përmbajë:

- a) pjesën hyrëse,** që përmban emrin e Komisionit: numri dhe data e vendimit; pala që i drejtohet (të dhënat e kërkuarit emër, mbiemër, atësi, amësi, datëlindje, vendlindje, adresa aktuale), objekti i shqyrtimit (njohja e periudhës përkatëse), bazat ligjore;
- b) pjesën arsyetuese:** që përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të dokumentacionit si dhe referencat ligjore mbi të cilat janë/është konkluduar për vendimmarrjen;
- c) dispozitivin:** ku pasqyrohet vendimmarrja e Komisionit. Në vendim pasqyrohet saktë se vendimi i Komisionit është përfundimtar në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës;

Vendimi i Komisionit, pavarësisht dispozitivit të tij, ka fuqi kur kanë votuar pro, ose kundër 3 nga 4 pjesëmarrësit.

Kur vendimmarrja e Komisionit nuk arrihet për shkak të mendimeve kundër, Komisioni bën një relacion përmbledhës dhe brenda ditës së nesërme të punës nga data e mbledhjes me anë të protokollit i dërgon praktikën për shqyrtim Drejtorit Rajonal.

Drejtori Rajonal në prezencë të Komisionit vlerëson praktikën dhe përcakton procedura të mëtejshme verifikimi ose në rast se verifikimet janë të plota jep mendimin e tij për refuzimin apo pranimin e kërkesës.

Mendimi i Drejtorit Rajonal faktohet në procesverbal, nënshkruhet nga ky i fundit dhe nga të gjithë pjesëmarrësit, i bashkohet votave të anëtarëve të Komisionit dhe vendimmarrja përfundimtare është ajo që ka marrë shumicën e votave.

Vendimi i Komisionit nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit dhe shoqërohet me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga Drejtori Rajonal. Pjesëmarrësit me mendim të kundërt vendosin shënimin "*kundër*" dhe nënshkruajnë.

Vendimi i Komisionit është përfundimtar në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe ka karakter deklarativ.

Kërkuesi në rast të rrëzimit, të pranimit të pjesshëm apo të mosmarrjes në shqyrtim të kërkesës, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Vendimi i Komisionit, mbahet në dy kopje, një kopje së bashku me të gjithë praktikën e parashikuar në nenin 7, administrohet në Degën e Arkivit, deri në momentin që bëhet pjesë e dosjes së një prej përfitimeve nga sigurimet shoqërore; një kopje nëpërmjet Protokollit të DRSSH dërgohet në Arkivin Qendror të ISSH-së.

Me marrjen e vendimit komisioni përpilon vërtetimin sipas modularit tip, në tre kopje ku një kopje së bashku me të gjithë praktikën e parashikuar në nenin 7, administrohet në Degën e Arkivit, deri në momentin që bëhet pjesë e dosjes së një prej përfitimeve nga sigurimet shoqërore; një kopje bashkë me Vendimin nëpërmjet Protokollit të DRSSH dërgohet në Arkivin Qendror të ISSH dhe një kopje e vërtetimit shoqëruar me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga titullari i DRSSH-së, i komunikohet kërkuesit jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga marrja e vendimit.

Drejtoria e Arkivit Qendror, regjistron në një regjistër të veçantë, vendimet e dërguara nga DRSSH-të, dhe merr masa për skanimin dhe numerizimin e tyre në bazën elektronike të të dhënave. Elementet e të dhënave të numerizuara, përcaktohen në dokumentin teknik të numerizimit dhe në manualin e hedhjes në sistem.

Komisioni, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme në vendim. Vendimi i korrigjimit bëhet pjesë e vendimit fillestar.

Neni 10

Të Fundit

Komisioni kur konstaton se kërkuesi ka bërë deklaram të rremë, në zbatim të nenit 4, të Ligjit nr. 169/2020, harton relacionin përkatës, e dërgon tek titullari i DRSSH-së/DSSH-së për kallëzim penal.

Shtojca bashkëlidhur është pjesë e Rregullores dhe është e detyrueshme për zbatim. Ajo mund të ndryshojë në çdo rast të ndryshimeve që mund të pësojnë aktet ligjore, nënligjore apo me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, kur sjellin përmirësim të shërbimit ndaj përfituesve.

Vendimet e Komisionit janë objekt i vlerësimit të ligjshmërisë nga strukturat audituese të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Sipas problematikave që konstatohen, me kërkesë të strukturave audituese të ISSH-së, vendimet e Komisionit adresohen për rishqyrtim nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së në strukturat përkatëse të këtij institucioni. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së, i njoftohet Drejtorisë Rajonale përkatëse, Drejtorisë së Arkivit Qendror, të cilët zbatojnë ndryshimet në masën e përfitimeve dhe në bazën e të dhënave.

Kërkesat e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në gjykatë.

Mos zbatimi i përcaktimeve në këtë Rregullore, ngarkon me përgjegjësi punonjësit përgjegjës, sipas parashikimeve të Rregullores në fuqi “Për personelin e ISSH-së”.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

SHTOJCË NR. 1

Dokumentacioni i domosdoshëm për t'u administruar është si më poshtë:

Dokumente që sigurohen nga nëpunësit e administratës	Dokumente që paraqiten nga aplikanti
1. Certifikatë familjare	1. Fotokopje e dokumentit të identitetit, e nënshkruar (emër, mbiemër, firma)
2. Vërtetim për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për burrat)	2. Certifikatë trangu familjar që vërteton përbërjen e tij në datën 19.07.1991, kur ka hyrë në fuqi Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar.
3. Verifikim në subjektet shtetërore dhe në ish-kooperativat bujqësore në të gjithë sistemin DMAIS (vërtetim negativ/pozitiv)	3. Certifikatë trangu familjar që vërteton përbërjen e tij në datën e largimit nga territori në të cilën ndodhej ish-kooperativa bujqësore, për të cilën kërkohet të njihet vjetërsia në punë.
4. Vërtetim nëse ka përfituar pension invaliditeti për periudhën e punësimit të deklaruar;	4. Certifikatë martese (për gratë)
5. Vërtetim nga Drejtoria e Burgjeve për kohen e vuajtjes së dënimit	5. Vërtetim nëse ka përfituar tokë në bazë të Ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar.
	6. Kopje të noterizuar e librezës së punës (nëse ka)
	7. Kopje e dëftesës së shkollës tetëvjeçare ose të mesme
	8. Dokumente të tjerë që zotërohen nga kërkuesi

Dokumentacioni duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë sipas legjislacionit në fuqi, origjinal, ose kopje e njësuar me origjinalin me akt noterial.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA RAJONALE _____

Nr. _____ Regj. datë ___/___/_____

KËRKESË- DEKLARATË

Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punës në ish-kooperativat bujqësore sipas Ligjit nr. 169/2020

Unë i nënshkruari _____ (emër mbiemër), deklaroj se kam punuar në kooperativën bujqësore _____ si punonjës bujqësie, me ditë pune. Për periudhën e punës dhe ditët e punës së realizuara çdo vit, nuk kam marrë asnjë njoftim nga ish-kooperativa bujqësore dhe nuk disponoj asnjë dokument. Jam informuar se për kooperativën bujqësore ku unë kam punuar nuk ka dokumentacion që të vërtetoj periudhën e sigurimit dhe ditët e punës të realizuara çdo vit.

Në këto kushte, bazuar në ligjin nr. 169/2020 dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave 432, datë 15.07.2021, kërkoj që periudha e sigurimit për efekt të përfitimit nga sigurimet shoqërore të përcaktohet në rrugë administrative nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Për këtë, bazuar në dispozitat e Ligjit të sipërsëhënuar dhe të legjislacionit Shqiptar, lidhur me përgjegjësinë personale, deklaroj si më poshtë:

1. Të dhëna personale:
 - a. Të dhënat personale aktuale.

NID	Emër	Atësi	Mbiemër	Mbiemër para martese
_____	_____	_____	_____	_____

Datëlindja	Vendlindja	Adresa	Numër telefoni
___/___/___	Fshati: _____ Qyteti: _____ Rrethi: _____	Lagjja: _____ Rruga: _____ Pall: _____; Shk. _____	_____ _____

	Qarku: _____	Qyteti/Fshati: _____	
		Qarku/Rrethi _____	

b. Të dhëna lidhur me ndryshimin e gjeneraliteteve (ndryshim emri, mbiemri, emri i babait)

Data e ndryshimit	Emri	Atësia	Mbiemri

2. Të dhëna lidhur me vendbanimin (ndryshimet e vendbanimit (nëse ka):

Vendbanimi(a) /Periudha (b)	Vendbanimi(a) /Periudha(b)
a	a.....
b.....	b.....

Shënim;

- në rreshtin “vendbanimi” shënohet emri i rrethit, emri i fshatit.
- në rreshtin “periudha”, shënohet periudha e banimit fillim mbarim me datë, muaj, vit.

3. Të dhëna lidhur me periudhën e punës në ish-kooperativë bujqësore.

Bazuar në Ligjin nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, deklaroj nën përgjegjësinë time se kam punuar dhe kam qenë banor i territorit në të cilin ka shtrirë aktivitetin e saj ish-kooperativa bujqësore si më poshtë vijon:

Nr.	Ish-kooperativa	Fshati	Sektori	Brigada	Data e fillimit të punës	Data e largimit të punës
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						

4. Deklarime për çështje dhe të dhëna të tjera, të përcaktuara në ligjin nr. 169/2020

(po /jo) Kam qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie. Nëse “po”, kam kryer dënimin, nga data, deri më datë, vendi i kryerjes së dënimit

(po /jo) Kam qenë përfitues i pensionit të invaliditetit të plotë. Nëse “po”, kam marrë pension invaliditeti, nga dataderi më datë në Drejtorinë Rajonale

(po /jo) Kam kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak . Nëse “po” kam kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak nga data deri më datë reparti

(po /jo) Kam frekuentuar arsimin 7/8 vjeçar. Nëse “po”, kam frekuentuar arsimin 7/8 vjeçar nga data deri më datë , në shkollënnë qytet/fshat

(po /jo) Kam frekuentuar arsimin e mesëm. Nëse “po”, kam frekuentuar arsimin e mesëm nga data deri më datë , në shkollënnë qytet/fshat, (me /pa) _____shkëputje nga puna.

5. Dokumentacioni shoqërues

Nr.	Dokumentacioni	
1.	Fotokopje e dokumentit të identitetit, e nënshkruar (emër, mbiemër, firma)	
2.	Certifikatë trangu familjar që vërteton përbërjen e tij në datën 19.07.1991, kur ka hyrë në fuqi Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar	
3.	Certifikatë trangu familjar që vërteton përbërjen e tij në datën e largimit nga territori në të cilën ndodhej ish-kooperativa bujqësore, për të cilën kërkohet të njihet vjetërsia në punë. (si pjesëtar i familjes bujqësore)	
4.	Certifikatë martese (për gratë)	
5.	Vërtetim nëse ka përfituar tokë në bazë të Ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar	
6.	Kopje të noterizuar të librezës së punës (nëse ka)	
7.	Kopje e dëftesës së shkollës tetëvjeçare ose të mesme	
8.	Dokumente të tjerë që zotërohen nga kërkuesi	
<i>Lidhur me pikën 8. Përshkrimi i dokumentit:</i>		

Deklaroj në përgjegjësinë time se të dhënat e mësipërme janë të vërteta, në të kundërt mbaj përgjegjësi sipas nenit 4 të Ligjit nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”.

Me vullnetin tim të lirë autorizoj punonjësit e ngarkuar të strukturave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të sigurojnë të dhënat dhe dokumentet administrative të nevojshme të ofruara nëpërmjet shërbimit publik elektronik, apo nëpërmjet shkëmbimit shkresor ndërinstytucional në atë masë që është e nevojshme për vlerësimin dhe plotësimin e kësaj kërkesë.

Pasi u njoha me kushtet ligjore, plotësova kërkesën e mësipërme, konfirmoj dorëzimin e dokumentacionit si më lart dhe nënshkruaj kërkesën në të gjitha faqet e saj.

Kërkuesi

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Pasi vlerësova kërkesën/deklaratën dhe në përputhje me Ligjin Nr. 169/2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore” dhe VKM Nr. 432, datë 15.07.2021 “Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë, e pranova dhe e paraqes për veprime të mëtejshme administrative.

Specialisti i pranimit

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA RAJONALE _____

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

“Për njohje të periudhës së punësimit në ish-kooperativë bujqësore për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore në zbatim të Ligjit nr. 169/2020”

Praktika “Për njohje të periudhës së punësimit në ish-kooperativë bujqësore për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore në zbatim të Ligjit nr. 169/2020”, kalon në

1. Kërkesa e Z/Znj. _____ regjistruar në Drejtorinë Rajonale _____ me nr. prot., datë _____, kalon te Drejtori Rajonal më datë _____.

Specialisti Protokollues

Drejtori Rajonal

2. Praktika e përshkruar në pikën 1, i kalon për shqyrtim Kryetarit të Degës së Arkivit më datë _____.

Drejtori Rajonal

Kryetari i Degës së Arkivit

3. Pasi shqyrtova praktikën e përshkruar në pikën 1, në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. _____/2021, sot më datë _____, realizova veprimet si vijon:

a)

b)

c)

ç)

d)

3.1. Praktika u plotësua me dokumentacionin e domosdoshëm më datë _____ dhe do të shqyrtohet në mbledhjen e datës _____, në Komisionin e përpunimit të praktikave “Për njohjen e periudhave të punësimit në ish-kooperativat bujqësore në zbatim të Ligjit nr. 169/2020”.

3.2. Komisioni pasi vlerësoi praktikën mori vendim nr. _____, datë _____.

Vërejtje:

3.3. Nga verifikimet rezulton se z/znj. _____, deri sot më datë _____:

- ka bërë kërkesë për caktim pensioni _____. Për këtë arsye praktika nëpërmjet protokollit dërgohet në Degën e Përfitimeve sot më datë _____.
- nuk ka bërë kërkesë për caktim pensioni. Për këtë arsye praktika administrohet në Degën e Arkivit deri në momentin e aplikimit për një përfitim.

3.4. Vendimet e shoqëruara me shkresë përcjellëse të nënshkruara nga Titullari dërgohen te Specialisti i Protokollit për të bërë veprimet përkatëse sot më datë _____.

Kryetari i Degës së Arkivit

Specialisti Protokollues

Vendimet e Komisionit në emër të z/znj. _____, u protokolluan me nr. _____, datë _____ dhe sot më datë _____, një kopje e vendimit ju dërgua kërkuarit, një kopje i dërgohet Drejtorisë së Arkivit Qendror të ISSH dhe një kopje së bashku me praktikën u kthye në degën e Arkivit/dërgohet në Degën e Përfitimeve për t’u bashkuar me praktikën për caktim pensioni.

Specialisti Protokollues

Kryetari i Degës së _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA RAJONALE _____
KOMISIONI I PËRPUNIMIT TË PRAKTIKAVE
“PËR NJOHJEN E PERIUDHAVE TË PUNËSIMIT NË ISH-KOOPERATIVAT BUJQËSORE NË
ZBATIM TË LIGJIT NR. 169/2020”

VENDIM

Nr. _____, datë _____.

Komisioni i përpunimit të praktikave “Për njohjen e periudhave të punësimit në ish-kooperativat bujqësore në zbatim të Ligjit nr. 169/2020” (në vijim Komisioni), në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore _____, shqyrtoi praktikën:

Kërkues:

Numri unik i identifikimit	
Emër, Atësi, Mbiemër	
Mbiemri para martesë (gratë)	
Datëlindja	
Vendlindja	
Adresa	

Me Objekt: Njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit:

Nr.	Ish-Kooperativa Bujqësore	Fshati	Sektori	Brigada	Data e fillimit të punës	Data e largimit të punës
1.						
2.						

Bazë Ligjore: Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”;
Ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore”, të ndryshuar;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 15,7,2021 “Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”.

Vendim i Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr. _____, datë _____ “Për miratimin e Rregullores “Për procedurat e funksionimit të komisioneve dhe veprimet administrative për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, ne zbatim të Ligjit nr. 169, datë 23.12.2020”.

dhe konstatoi se është kompetent për shqyrtimin e kësaj praktike, bazuar në legjislacionin e sipërcituar.

Komisioni bëri vlerësimin e hollësishëm të çdo dokumenti veçmas dhe të gjitha dokumenteve së bashku të paraqitura dhe të administruara për efekt të këtij kërkimi dhe arrin në përfundimin duke arsyetuar si më poshtë:

“kërkesa plotëson kriteret e Ligjit nr. 169/2020:

- *subjekti është i pasqyruar në listën e VKM nr. 432/2021;*
- *kërkuesi është në moshën ligjore për punë sipas dispozitave të legjislacionit të punës të periudhës;*
- *subjekti në periudhën objekt deklarimi rezulton i krijuar dhe në proces të ushtrimit të aktivitetit të tij;*
- *nuk vërtetohet se periudhat e punësimit të deklaruara të krijojnë mbivendosje me periudha të tjera sigurimi, apo me periudha të tjera të cilat bëhen pengesë për të pasur një marrëdhënie pune, si kryerje e shkollës me shkëputje nga puna, dënim me heqje lirie, trajtim me pension invaliditeti në kushtet e humbjes së aftësisë për punë në masë të plotë;*
- *kërkuesi në periudhën e deklaruar rezulton banor në lokalitetin në të cilin ka ushtruar veprimtarinë kooperativa bujqësore;”*

Për këto arsye, Komisioni:

VENDOSI

1. Të _____ kërkesën e z/znj. _____.
2. Të _____ si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore periudhën e punësimit në ish-kooperativën bujqësore _____, fshati _____, brigada/sektori _____, si vijon:

Viti Kalendarik	Shuma e ditëve të punës vjetore		Viti Kalendarik	Shuma e ditëve të punës vjetore	
	Me shifra	Me fjalë		Me shifra	Me fjalë

3. Ky vendim është përfundimtar në sistemin e sigurimeve shoqërore.

KRYETARI

ANËTARË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA RAJONALE _____

Nr. _____ prot.

Datë _____._____._____

VËRTETIM

Në zbatim të Ligjit nr. 169/2020, datë 23.12.2020 "Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 15,7,2021 "Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë" dhe bazuar në Vendimin nr. _____, datë _____, vërtetohet se:

Emër, Atësi, Mbiemër, Mbiemër para martese	
datëlindja	
Vendlindja	

Ka qenë në marrëdhënie pune në ish-kooperativën bujqësore _____, fshati _____, brigada/sektori _____, si vijon:

Viti Kalendarik	Shuma e ditëve të punës vjetore		Viti Kalendarik	Shuma e ditëve të punës vjetore	
	Me shifra	Me fjalë		Me shifra	Me fjalë

Ky vërtetim është i vlefshëm vetëm për efekt të përfitimeve nga sistemi i sigurimeve shoqërore.

KOMISIONI

DREJTORI
